



Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,
mbajtur më 27.2.2024, e cila filloj në orën 15:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Edmond Azemi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Violeta Salihu (LVV), Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Arbër Limani (LVV), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Endrit Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Fehmi Kupina (i pavarur).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Agim Kuleta (LB), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Sami Salihu (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Osman Bllaca, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Pëllumb Bajçinovci**, kryesues i Kuvendit. Ai tha se para se të fillojmë me rendin e ditës, Arbër Limani, anëtar i ri i Kuvendit, duhet të betohet para Kuvendit.

Arbër Limani, anëtar i ri i Kuvendit nga subjekti politik LVV, e bëri betimin para Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Përparim Rama, kyetar, tha se tani kur transformimi i qytetit po merr formë në Prishtinë, kur qindra projekte zhvillimore po zbatohen në terren, po tentohet të ndalet zhvillimi i Prishtinës për inate politike. Kjo është politika e juaj, politikë e bllokimit të kryeqytetit dhe qytetarëve të saj dhe kur po ndodh kjo, po ndodh sot, kur rruga "Xhim

Faqe 1 nga 4

Xhemë", apo siç njihet rruga "A", njëri ndër projektet më zhvillimore në vend, është duke u realizuar në kohë rekorde, kur jemi duke përfunduar Unazën e brendshme, kur kemi nisur ndërtimin e gjashtë shkollave të mëdha në kryeqytet, ndërtimin e gjashtë çerdheve për fëmijë, kur kemi shtrirë ndriçimin publik në qytet e në fshatra, kur kemi shtrirë ngrohjen qendore në shumë lagje, kur po ndodhin investime serioze në shëndetësi, sport, kulturë, në parqe e në gjelbërim, të cilat nuk kanë ndodhur vite me radhë. Iniciativa e sotme që po propozohet, kjo tentativë për me rrëmbyer pushtet, është një shuplakë për çdo banor të Prishtinës. Është përpjekje e hapur për me e bllok zhvillimin e qytetit. Jemi zgjedh me i përfaqësuar qytetarët e jo me u marrë me lojëra egoiste politike.

Ju lus që të mos e votoni këtë rrëmbim të pushtetit, që synimin e fundit e ka robërimin e së ardhmes së qytetit tonë. Konsideroj se shkarkimi i kryesuesit, z. Pëllumb Bajçinovci, nuk qëndron, dhe është i pajustifikueshëm shkarkimi i tij.

Pas këtij diskutimi, në shenjë pakënaqësie, z. Përparim Rama, kryetar, dhe z. Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, e lëshuan mbledhjen.

Osman Billaca tha se në mungesë të kryesuesit të Kuvendit, përsori më i moshuar i pranishëm nga anëtarët e Kuvendit duhet ta udhëheqë mbledhjen.

U konstatua se mbledhjen e Kuvendit do ta udhëheq Nora Kelmendi.

Nora Kelmendi, kryesuese e mbledhjes, tha se për këtë mbledhje është propozuar ky

Rend i ditës:

1. Propozim-vendimi për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.

Nora Kelmende, kryesuese, hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Gëzim Sveçla tha se nuk kishte një mënyrë më të mirë se me shpërfaqur kryetarin Rama sesa mënyrën që ai vetë na u imponua, iu drejtua seancës në një mënyrë krejtësisht klandestine, sikur të ishte në fushatë zgjedhore, në një seancë të jashtëzakonshme e cila ka një pikë të rendit të ditës. Kryetari që gjatë fjalimit të tij foli për unitet e veprimin e fundit që e bëri, iku nga mbledhja dhe në anën tjetër në mbledhje nuk është asnjë përfaqësues i ekzekutivit. Ne si Grup parlamentar e kemi ndërmarrë këtë hap për shkarkimin e kryesuesit me arsyetimin se, duke u nisur nga fakti që edhe pak ditë jemi në muajin e tretë të këtij viti dhe Kuvendi komunal i Prishtinës ende nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të rregullt, duke konstatuar që kryesuesi i Kuvendit komunal nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që kishte me zhbllokuar situatën e krijuar në Kuvend. Po ashtu, nuk ka arritur të krijojë kushte të nevojshme ose të paktën të përpinqet për krijimin e këtyre kushteve për tejkalimin e kësaj bllokade në Kuvendin komunal. Është evidente që z.Bajçinovci ka dështuar në përbushjen e detyrave të tij dhe ka treguar nivel të ulët të performancës së tij.

Bazuar në të gjitha këto çfarë u thanë dhe me qëllim të kthimit të funksionalitetit të Kuvendit, propozojmë që sot ne asamblistët e kryeqytetit nga subjektet e ndryshme politike, të votojmë për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit.

Leutrim Retkoceri tha se sot jemi në ditën e 68-të prej kur Kuvendi i kryeqytetit nuk ka mbajtur asnje seancë të rregullt, më shumë ka pasur seanca të jashtëzakonshme sesa seanca të rregullta, e që kjo dëshmon se në çfarë gjendje gjendet Kuvendi, e ky Kuvend duhet të marrë drejtimin e vetë që të dalë nga kjo situatë bllokuese e krijuar dhe kjo situatë e krijuar vjen pashmangshëm nga Përparim Rama. Kryetari e ka humbur shumicën në Kuvendin komunal, sepse nuk e ka respektuar as qytetarin, as vetëveten, e as partnerin, Uroj që kjo situatë të marrë zgjidhje. Kuvendin dhe kryesuesin nuk mund ta mbajë peng as Përparimi e as Pëllumbi. Kemi pritur tash e sa ditë të gjithë së bashku, asamblistë, qytetarë, media dhe po besoj që të gjitha grupet tjera të interesuara, që të kemi një seancë të rregullt, në mënyrë që të vihet një propozim për krijimin e shumicës, mirëpo nuk është kjo. Unë nga këtu e ftoj Përparimin që të angazhohet seriozisht për formimin e shumicës në Kuvend. PDK nuk ka propozues për kryesues të Kuvendit.

Është shumë e rëndësishme që tash e tutje Kuvendi me veprimin e sotëm dhe me propozimet e së nesërmes, të marrë rrugë për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. PDK në asnje moment nuk do të bllokojë këtë Kuvend dhe punën e përfaqësuesve, diskutimet e qytetarëve, përfaqësimi i qytetarëve duhet dhe besoj se do të kthehet në Kuvend nga këtu ku buron legjitimiteti i çdo qeverisje tjetër për të vazhduar përpara. Uroj që së shpejt i kemi edhe propozimin për shumicën e re të krijuar. Gjithashtu pres që propozimi i kryesuesit të Kuvendit dhe i trupave tjera të Kuvendit, të vijë sa më shpejt në këtë Kuvend. **Bahri Gashi** tha se me akuzat e kryetarit të cilat i bëri ndaj nesh, ato i qëndrojnë më së shumti atij, sepse nuk ka filluar sot mandati i tij që ka filluar me bërë shkolla, por ka filluar qe dy vite e gjysmë, edhe shumë vonë po na tregon, ende nuk i kemi parë ato shkolla. Unë kësaj përbërje i uroj sukses dhe si AAK do ta përkrahim këtë iniciativë të mirë për qytetarët dhe për Prishtinën.

Gëzim Mehmeti tha se fjalimi i kryetarit më nxiti, për arsyen se u thanë shumë të pavërteta, ishin shprehje ofenduese, të cilat nuk mund t'i paramendoj, kështu që kryetar çështjet themelore esenciale nuk i njeh. Nuk rrëmbehet pushteti, kryetar, ligjet e Republikës së Kosovës e definojnë se shumica, me 26 anëtarë të pranishëm përfundon, dhe të bësh populizëm me çështje aspak të vërteta, kjo tregon se ju kryetar keni humbur. Premtimet e juaja janë në një formë jo përbajtjesore, çdo gjë është tek ti vetëm çështje sipërfaqësore. **Endrit Zabërgja** tha se nëse e shohim sot se në çfarë situate gjendet kryeqyteti, besojë se është më shqetësuese sesa arsyaja që jemi mbledhur sot. Kuvendi komuna i Prishtinës në realitet po bëhet jo funksional dhe kjo pikë nuk jam i sigurt se do t'i shërbejë funksionalitetit të vazhdueshëm apo funksionalizimit të këtij Kuvendi komunal. Në fakt, ajo se çfarë unë besoj është që me aktet e tillë më shumë simbolike sesa përbajtjesore, ne vetëm sa po i kontribuojmë destabilizimit të vazhdueshëm të spektrit politik në kryeqytet dhe, në fund të fundit, pasojat më të mëdha do të ndihen tek qytetarët. Çfarë është interesante, është ky

Faqe3nga4

afeksioni kaq i shpejtë i bashkëpunimit të Partisë Demokratike të Kosovës me Lëvizjen Vetëvendosje, dhe kjo qasja e Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ndaj qeverisjes aktuale. Tani është nevoja e krijimit të një shumice, nevoja për vazhdimin e projekteve, sepse në këtë formë ne nuk jemi duke e dëmtuar një individ, jemi duke i bllokuar edhe ato projekte të cilat janë në vazhdimësi për kryeqytetin, andaj unë do të jem këtu vazhdimesht duke tentuar që hipokrizitë aktuale sikur tani, në rastin e tillë t'i demaskojmë. Ky kualicion nuk do të përkrahet asnjëherë nga Nisma Socialdemokrate. **Nora Kelmendi** tha se, nëse nuk ka dispozitë ligjore e cila e përcakton mënyrën e shkarkimit, atëherë duhet të ndiqet mënyra e njëjtë sikurse mënyra e emërimit të kryesuesit. Fillimisht, duhet të formohet një komision prej tre anëtarëve, të cilët do të udhëheqin procesin e votimit, ku votimi do të jetë me vota të fshehta.

Gëzim Sveçla, për anëtar të komisionit nga GP i LVV-së, propozoi z. Mirsad Vitia. **Leutrim Retkoceri**, për anëtar të komisionit nga GP i PDK-së, propozoi znj. Gresa Lahu. **Bahri Gashi**, për anëtar të komisionit nga GP i AAK-së, propozoi z. Endrit Gashi.

Mirsad Vitia, në emër të komisionit, tha se nga gjithsej 33 pjesëmarrës, anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës në votim, më 33 vota për, shkarkohet kryesuesi i Kuvendit Pëllumb Bajçinovci.

Kryesuesja konstatoi se më 33 vota për, u miratua Vendimi për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit z. Pëllumb Bajçinovci.

Mbledhja përfundoi në orën 16:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesja e mbledhjes së Kuvendit
Nora Kelmendi



Faqe4nga4